



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, më tej "LAC", ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Në pajtim me nenin 23.1 dhe 26.1 të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës, datë 17 janar 2011, (më tej Rregullorja e brendshme),

Me qëllim të realizimit të konsultimeve publike dhe përfshirjes kuptimplotë të palëve të interesuara gjatë hartimit të akteve nënligjore nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 1/2012
PËR PROCEDURAT E KONSULTIMIT PUBLIK TË PALËVE TË INTERESUARA**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përshkrimi i procedurave të konsultimit publik të palëve të interesuara gjatë hartimit të akteve nënligjore nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, të cilat parashihen sipas dispozitave të LAC dhe Rregullores së brendshme.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ do të zbatohet nga strukturat e AAC-së që janë të përfshira në hartimin e akteve nënligjore që parashihen me nenin 23.1 të Rregullores së brendshme.

Neni 3

Përkufizimet

Strukturë e AAC-së - nënkupton definicionin e përfshirë në nenin 5 të Rregullores së brendshme.

Palë e interesuar - nënkupton çdo person, në kuptim të nenit 4.1 të Ligjit për Aviacionin Civil, veprimtaria e të cilit përfshin ofrimin e ndonjë shërbimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në fushën e aviacionit civil.

Neni 4

Obligimi për konsultim

4.1 Strukturat e AAC-së duhet të përpiqen në mënyrë të arsyeshme që të respektojnë procedurën e konsultimit publik të krijuar me këtë Udhëzim Administrativ.

4.2 Çdo person i cili shpreh interesim të marrë pjesë në proces të konsultimit publik lidhur me një akt nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet ta ketë mundësinë t'i shprehë komentet dhe vërejtjet lidhur me aktin i cili është në procedurë të konsultimit publik.

Neni 5

Procedura e konsultimit publik

5.1 AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuara.

5.2 AAC-ja do ta publikojë çdo projekt akt të paraparë në nenin 23.1 të Rregullores së brendshme, duke e caktuar afatin prej së paku **15** ditësh për pranim të vërejtjeve dhe komenteve.

5.3 Në rast të zgjedhjes së metodës së paraparë në paragrafin 1 pika (a) të këtij neni, AAC-ja do të mundësojë aplikacionin përkatës në faqen e vet zyrtare të internetit, ose do ta caktojë një adresë elektronike ku mund të depozitohen komentet dhe vërejtjet, me udhëzimet përkatëse për palët e interesuara.

5.4 Aplikimi i metodës së paraparë në paragrafin 1 pika (b) të këtij neni, do të varet nga shprehja e interesit të së paku dhjetë (10) pjesëmarrësve gjatë procedurës së konsultimit

dhe nga disponueshmëria e kushteve logjistike për organizimin dhe mbajtjen e takimit.

5.5 Në çdo rast, nëse plotësohet kushti i dhënë në paragrafin 4 për numrin e pjesëmarrësve, AAC-ja do ta konfirmojë mbajtjen e takimit, jo më vonë se dy javë pas skadimit të afatit të dhënë në paragrafin 2 të këtij neni, duke e caktuar vendin dhe kohën e mbajtjes së tij. Për këto takime do të mbahet procesverbali.

5.6 Në rastet kur pranohen vërjetjet dhe komentet sipas paragrafit 3 të këtij neni, AAC-ja do të ofrojë përgjigje me shkrim, jo më vonë se dy javë pas skadimit të afatit të dhënë në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 6 Evidentimi i materialeve

6.1 Të gjitha materialet e pranuar nga palët e interesuara gjatë procesit të konsultimit publik, me shkrim apo të regjistruara në procesverbal gjatë takimeve, do të evidentohen dhe do të konsiderohen gjatë hartimit përfundimtar të akteve nënligjore të parapara me nenin 3.1 të këtij Udhëzimi Administrativ.

6.2 Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, të gjitha materialet e pranuar, së bashku me përgjigjet e dhëna, do të arkivohen dhe do të ruhen në arkivin e AAC-së në përputhje me ligjin.

Neni 7 Mbrojtja e pronësisë intelektuale

AAC-ja do t'i trajtojë të gjitha materialet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik, në përputhje me ligjin e aplikueshëm për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi më 1 shkurt 2012.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm